

Edmond SPAHO



Datëlindja: 14.11.1958

Vendlindja:

E-mail: Edmod.Spaho@parlament.al

Jetëshkrimi

Ka përfunduar Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës në vitin 1982.

Në vitin 1992 ka kryer studimet për politikat dhe programimin financiar në Institutin e FMN-së në Uashington D. C. Në vitet 1995–1996 ka kryer studimet pasuniversitare për administrim biznesi në Universitetin e Bowling Green, Ohio, USA.

Ka mbajtur funksione të ndryshme në administratën shtetërore, si zëvendës drejtor i përgjithshëm i Rezervave të Shtetit, drejtor i Drejtorisë Makroekonomike në Ministrinë e Financave, zëvendësministër dhe Ministër i Turizmit.

Anëtar i Partisë Demokratike që nga krijimi i saj, sekretar për Ekonominë, anëtar i Këshillit Kombëtar dhe i Kryesisë së Partisë Demokratike që nga viti 2001. Në vitet 2014–2021 u zgjodh nënkryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë

Deputet i Partisë Demokratike në qarkun e Korçës dhe të Elbasanit që nga viti 2005, kryetar i Komisionit të Përhershëm për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë në legjislaturat 2005–2009 dhe 2009–2013.

Në legjislaturën 2013–2017 u zgjodh zëvendëskryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Në legjislaturën 2017–2021 ka mbajtur funksionin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Në legjislaturën 2021–2025 u zgjodh Deputet i qarkut të Korçës dhe është anëtar i Komisionit të Përhershëm për Ekonominë dhe Financat.

Të tjera:

Në vitet 1994–1996 është zgjedhur president i Federatës Shqiptare të Futbollit.

Në vitet 1998–2005 ka qenë drejtor i Qendrës Kombëtare të Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC), themeluar dhe financuar nga USAID-i.